



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



---

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17 dhjetor 2012), nenit 20, paragrafit 3, nënparagrafit 3.1 të Rregullores QRK, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 33.2, shkronja a), dhe nenit 34.1 shkronja d), të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2017, merr këtë

## V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Federatës së Tenisit të Kosovës, pa procedurë konkurrimi.
- II. Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim ka këto karakteristika: parcela kadastrale nr. 2504-0, Zona kadastrale Prishtinë, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 64588 m<sup>2</sup>, jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 9059 m<sup>2</sup>, e evidentuar si "pasuri shoqërore - Kuvendi komunal Prishtinë".
- III. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të përshkruar në pikën II të këtij Vendimi është për periudhë afatshkurtër për 15 vjet.
- IV. Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim, me qëllim të ndërtimit të 6 fushave të reja të tenisit.

- V. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VI. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është skica gjeodezike.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01. 464/01-0245970/17, më 02.10.2017



**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Halim Halimi, jur.i dipl.**